



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR

Nr. 1233 Prot

Shkodër, më 22.01.2021

URDHËR ANKANDI
Nr. 54 Datë 22.01.2021

**“PËR NJË NDRYSHIM NE URDHËRIN NR.44 , DATE 19.01.2021, PËR
KRIJIMIN E NJËSISË SË ANKANDIT ME OBJEKT: “SHITJEN ME ANKAND TË
AKSIONEVE TË KLUBIT TË FUTBOLLIT ‘VLLAZNIA’ SHA NË MASËN
100%”.**

Mbështetur në ligji nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar; ligji nr. 9874 datë.14.02.2008 “Për ankandin publik” i ndryshuar; ligji nr.9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” të ndryshuar, ligji nr.79/2017 “Për sportin” i ndryshuar; VKM nr.1719 datë.17.12.2008 “Për miratimin e rregullave të ankandit publik” të ndryshuar; VKB nr.54, datë 27.11.2020 “Për miratimin për shitjen me ankand të aksioneve të Klubit të Futbollit “Vllaznia” sha në masën 100%”, shkresa nr. 53 prot, datë 14.01.2021 e Federatës Shqiptare të Futbollit,

URDHËROJ:

1. Të kryhet procedura e ankandit publik me objekt “Shitjen me ankand të aksioneve të klubit të futbollit ‘Vllaznia’ sha në masën 100%”.
2. Vlera fillestare e ankandit është 50,794,000 (pesëdhjetë milion e shtatëqind e nëntëdhjetë e katër mijë) lekë.
3. Lloji i procedurës së ankandit është “Procedure e hapur”.
4. Njësia e ankandit do të përbëhet nga:
 - Ardit Çylybyli Kryetar
 - Vinifreda Gazulli Anëtar
 - Manjola Fushaxhija Anëtar
 - Aldi Topçiu Anëtar Drejtor i Departamentit Ligjor pranë FSHF
 - Kristaq Ndini Anëtar Ekspert i kriterit financiar pranë FSHF
5. Njësia e ankandit është përgjegjëse për hartimin e dokumenteve të ankandit, për shqyrtimin, vlerësimin dhe krahasimin e ofertave dhe për kryerjen e të gjitha veprimeve e procedurave në përputhje me legjislacionin dhe rregullat e ankandit publik në fuqi.
6. Për zbatimin e këtij urdhëri ngarkohet Njësia e Ankandit.
7. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

TITULLARI I AUTORITETIT SHITËS
VOLTANA ADEMI

